



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM Durrës

FUNKSIONET DHE DETYRAT E GJYKATËS

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 98/2016, “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe parashikimeve ligjore në fuqi (Juridiksioni i Gjykatës shtrihet në 4 (katër) Bashki, konkretisht Bashkia Durrës, Bashkia Kavajë, Bashkia Shijak, Bashkia Rogozhinë).

Funksioni kryesor i Gjykatës është dhënia e drejtësisë, nëpërmjet vendimeve gjyqësore në përfundim të procesit gjyqësor.

Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat e Shkallëve të Para, të cilat krijohen me ligj.

Pushteti gjyqësor ushtrohet “Në emër të Republikës”, në përputhje me Kushtetutën, dhe me legjislacionin në fuqi. Gjyqtarët, gjatë ushtrimit të funksionit dhe vendimmarrjes, janë të pavarur dhe të paanshëm.

Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Kategoria e Dytë, sikundër është iGJSHPPD, **organizohet dhe funksionon** në bazë të **parimit** të hierarkisë, llogaridhënies, ligjshmërisë, efektivitetit, paanshmërisë, transparencës, aksesit në drejtësi si dhe bashkëpunimit institucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke respektuar, në të njëjtën, kohë pavarësinë dhe paanësinë e gjyqtarëve të saj. Si autoritet publik i sistemit gjyqësor, Gjykata garanton ushtrimin e funksionit të saj, kryesisht nëpërmjet dhënies së vendimeve gjyqësore në shkallën e parë të gjykimit.

Në ushtrimin e pushtetit gjyqësor çdo gjykatë ndihmohet nga **administrata gjyqësore**, e cila përfshin shërbimet e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe shërbime të tjera mbështetëse. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, administrata gjyqësore respekton pavarësinë e gjyqtarëve, duke shmangur çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor.

Çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor sjell përgjegjësi sipas ligjit.

Sipas Nenit 5 i Vendimit Nr. 150, datë 29.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, parashikohet:

“Organet vendimmarrëse”

1. **Organet vendimmarrëse të Gjykatës** janë:

- a) Kryetari;
- b) Këshilli i Gjykatës;
- c) Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve;
- ç) Kancelari.

2. **Kryetari** është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e përgjithshëm gjyqësor të gjykatës, sipas ligjit dhe kësaj rregullore.
3. **Këshilli i Gjykatës** përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe kancelari. Ai është përgjegjës për mirëfunksionimin e shërbimeve administrative të gjykatës, sipas ligjit dhe akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për këtë qëllim.
4. **Zëvendëskryetari** ushtron kompetencat e kryetarit në mungesë të tij.
5. **Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve** përbëhet nga të gjithë gjyqtarët e gjykatës dhe ushtron kompetencat sipas ligjit.
6. **Kancelari** është nëpunësi civil gjyqësor më i lartë dhe përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor, sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, shpreh gatishmërinë maksimale në kuadër të bashkëpunimit si dhe mbetet e gatshme për çdo sqarim apo eventualitet të mundshëm.

ⁱ Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës